



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2014/03

Bazuar në Nenin 3, paragrafi 2.5 dhe 2.6 dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), KPM miraton:

RREGULLORE PËR NIVELIN DHE MËNYRËN E PAGESËS SË TARIFËS PËR LICENCË

NENI 1 QËLLIMI

1. Përcaktimi i nivelit të tarifës për aplikim për licencë të KPM-së për të gjitha kategoritë e të licencuarve të KPM-së.
2. Përcaktimi i nivelit dhe mënyrës së pagesës së tarifës vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e të licencuarve të KPM-së.
3. Përcaktimi i nivelit të tarifës në lidhje me ndryshimin apo vazhdimin e licencës së KPM-së për të gjitha kategoritë e të licencuarve të KPM-së.

NENI 2 KATEGORIZIMI I SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUELE ME FREKUENCË

1. **Kategoria me mbulim nacional**, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat, përmes rrjetit frekuencor të koordinuar në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës për transmetim tokësorë, mbulojnë me sinjal radio televiziv mbi 80% të popullsisë së Republikës së Kosovës;
2. **Kategoria me mbulim regjional**, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat mbulojnë me sinjal radio televiziv, përmes frekuencës, më shumë se tri komuna (15-30% të popullsisë së Republikës së Kosovës);
3. **Kategoria me mbulim lokal**, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat ofrojnë mbulim me sinjal radio televiziv, përmes frekuencës, deri në tri komuna (deri në 15% të popullsisë së Republikës së Kosovës);
4. **Kategoria me fuqi të ulët transmetimi**, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat transmetojnë, përmes frekuencës, me më pak se 50W fuqi transmetimi.

NENI 3 TARIFA PËR APLIKIM PËR LICENCË

Aplikuesit me rastin e dorëzimit të aplikacionit për licencë duhet ta paguajnë një tarifë administrative në shumën prej njëqind Euro (100 €) në llogarinë bankare të KPM-së. Pavarësisht vendimit të KPM-së, tarifa administrative nuk i kthehet kandidatit.

NENI 4 KRITERET E VLERËSIMIT TË TARIFËS VJETORE

1. Kriteret e vlerësimit të tarifës vjetore për shërbimet mediale audio-vizuele (me frekuencë) përcaktohen në bazë të:
 - a) Vlerës bazë të shprehur (A) – e llogaritur në bazë të buxhetit të përgjithshëm vjetor të shërbimeve mediale audiovizuale.
 - b) Numrit të banorëve (B);
 - c) Llojit të shërbimit medial audiovizuel (C) – radio dhe TV dhe
 - d) Kategorisë së subjektit transmetues tokësor (D).

2. Kriteret e vlerësimit të tarifës vjetore për operatorët e rrjetit përcaktohen në bazë të:
 - a) Numrit të banorëve (A);
 - b) Numrit të parapaguesve potencial (B);
 - c) Përpjesëtimit të tregut (C);
 - d) Çmimit mesatar të parapagimit (D) dhe
 - e) Përqindjes së buxhetit të përgjithshëm (E).

3. Për shërbimet mediale audio-vizuele që nuk përdorin frekuencë, vlera e tarifës vjetore është e njëjtë sikurse për shërbimet mediale audiovizual me frekuencë, që i përkasin kategorisë me mbulim regional.

NENI 5 TARIFAT VJETORE TË TARIFËS PËR LICENCË

1. Niveli i tarifës vjetore për shërbimet mediale audiovizuale që operojnë me frekuencë është përcaktuar si në vijim:

Lloji i subjekteve transmetuese tokësore	Tarifa vjetore
Radio me fuqi të ulët	240.00 (€)
TV me fuqi të ulët	360.00 (€)
Radio lokale	540.00 (€)
TV lokale	810.00 (€)
Radio regjionale	1,260.00 (€)
TV regjionale	1,890.00 (€)
Radio nacionale	10,080.00 (€)
TV nacionale	15,120.00 (€)

- Shuma e tarifës vjetore për licencë për operatorët e rrjetit që ofrojnë shpërndarjen e shërbimeve audio dhe audiovizuale do të llogaritet për secilën komunë dhe zonë kadastrale në të cilën operatori ofron shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Niveli i tarifës vjetore të licencës është përcaktuar si në tabelën në vijim:

Komunat	Tarifa Vjetore
Prishtina	8,884.00 (€)
Prizreni	3,932.00 (€)
Ferizaj, Mitrovica, Peja, Gjilani, Gjakova, Podujeva	2,012.00 (€)
Komunat tjera; zonat kadastrale	533.50 (€)

- Tarifa vjetore për shërbimet mediale audiovizuale (TV) që operojnë përmes operatorëve të rrjetit që ofrojnë shpërndarjen e shërbimeve audio dhe audiovizuale, të cilët nuk shfrytëzojnë frekuencë, do të jetë ekuivalente me tarifën vjetore të aplikuar për shërbimet mediale audiovizuale me frekuencë (TV), që i përkasin kategorisë me mbulim regjional (1,890.00 euro).
- Tarifa vjetore për shërbimet mediale audiovizuale (radio) që operojnë përmes shpërndarësve të shërbimeve audio dhe audiovizuale, të cilët nuk shfrytëzojnë frekuencë, do të jetë ekuivalente me tarifën vjetore të aplikuar për shërbimet mediale audiovizuale me frekuencë (radio), që i përkasin kategorisë me mbulim regjional (1,260.00 euro).

NENI 6 MËNYRA E PAGESËS SË TARIFËS VJETORE

- Tarifa Vjetore për licencë, për të gjithë kategoritë e të licencuarve të KPM-së, do të depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media, jo më vonë se më 31 mars të vitit respektiv.
- Në rastin e licencimit, tarifa e parë vjetore për licencë do të paguhet jo më vonë se 14 ditë nga pranimi i vendimit për licencim, ndërsa llogaritja e tarifës vjetore e licencës do të bëhet nga muaji në të cilin merret vendimi për licencim.
- Në rast se të licencuarit nuk e informojnë Komisionin e Pavarur të Mediave se nuk planifikojnë të vazhdojnë së ushtruar veprimtarinë e tyre më tutje, përgjegjësitë financiare që rrjedhin nga licenca do të jenë të vlefshme deri në momentin e dorëzimit të njoftimit me shkrim në KPM që i licencuari heq dorë nga licenca.
- Edhe nëse i licencuari ndërpreu aktivitetin para skadimit të kohës për të cilën kohë tarifa është paguar, pjesa e shumës së tarifës për kohën e mbetur nuk do të kthehet.

NENI 7
TARIFA PËR NDRYSHIM DHE VAZHDIMIN E LICENCËS

Me rastin e dorëzimit të kërkesës për ndryshim të licencës ose vazhdim të licencës, aplikuesit duhet ta paguajnë një tarifë administrative në shumën prej njëqind Euro (100 €) në llogarinë bankare të KPM-së. Pavarësisht vendimit të KPM-së, kjo tarifë administrative nuk i kthehet kandidatit.

NENI 8
SANKSIONET


Në rast të mospagesës me kohë të tarifës për licencë KPM do të ndërpresë apo refuzojë vazhdimin e licencës së KPM-së në pajtim me Ligjin e KPM-së.

NENI 9
DISPOZITAT KALIMTARE

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja KPM-2010/02.

NENI 10
HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



30.12.2014

Datë